



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E APELIT  
TIRANE

Nr.226/90 Regj Themeltar.  
Nr.49 Vendimi.

V E N D I M  
"NE EMER TE REPUBLIKES"

Gjykata e Apelit Tirane e perberë nga gjyqtaret :

KRYESUES:ELBANA LLURI  
ANETAR: ZEGJINE SOLLAKU  
ANETAR: ELONA TORO

Asistuar nga sekretare gjyqsore *Matilda Bako*, sot me **04.05.2021**, mori ne shqyrtim ne seance gjyqsore publike ne shkalle te dyte, kerkesen civile nr.226/90 Regj. Themeltar, me :

**KERKUES:**

**Shoqeria "GBC Oil Company" LTD Cayman Islands**, perfaqesuar nga dega e shoqerise se huaj Transatlantic Albania Ltd – identifikuar me NIPT K72205016P, perfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor z.Naim Kasa, i cili ka autorizuar me procure av.Besnik Strati si perfaqesues ne gjykim.

**OBJEKTI:**

Njohjen e vendimit gjyqësor të Gjykatës Ndërkombetare të Arbitrimit të Dhomës Ndërkombetare të Tregtisë, të mbajtur në Zvicër, Zyrih Nr. 22676/GR ceshtje e datës 06.07.2020.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 393-397 e vijues te K. Pr.Civile.

*Gjykata e Apelit Tirane*, ne seance gjyqsore, pasi shqyrtoi ceshtjen dhe administroi provat e nevojshme gjate gjykimit.



**VEREN:**

Në kërkesën drejtuar gjykatës, kërkuesi **Shoqeria "GBC Oil Company" LTD Cayman Islands**, përfaqësuar nga dega e shoqërisë së huaj Transatlantic Albania Ltd, ka kërkuar që vendimit të formës së prerë të Gjykatës Ndërkombetare të Arbitrimit të Dhomës Ndërkombetare të Tregtisë, të mbajtur në Zvicër, Zyrih Nr. 22676/GR, t'i jepet fuqi ligjore, bazuar në legjislacionin e shtetit shqiptar, nenet 395, 396, 397 e 398 të Kodit të Procedurës Civile.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi e provuar se nëpërmjet vendimit nr.22676/GR datë 06.07.2020, të Gjykatës Ndërkombetare të Arbitrazhit Dhoma Ndërkombetare e Tregtisë, është vendosur njohja e detyrimeve për kërkuenin me cilësinë e kreditorit kundrejt Ministrise se Infrastrukturës dhe Energjisë, AKBN dhe AlbPetrol sha.

*Gjykata e Nderkombetare e Arbitrazhit me vendimin që kërkohet të njihet gjyqësisht*, në dispozitivin e saj është shprehur si më poshtë vijon:

- (i) Vendos që i Padituri 1 (Parë) në këtë arbitrazh është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë (si pasardhësi ligjor i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë sipas Licensë Marrëveshjeve);
- (ii) Vendos që ka juridiksion për të dëgjuar pretendimet kundër MIE, AKBN dhe AlbPetrol që i përkasin fushës së Licensë Marrëveshjes Cakran, Licensë Marrëveshjes Gorisht dhe Licensë Marrëveshjes Ballsh;
- (iii) Vendos MIE dhe AKBN kanë shkelur detyrimet e tyre për të zbatuar masat e stabilizimit fiskal sipas nenit 3.1 (c) të Licensë Marrëveshjes Cakran, Licensë Marrëveshjes Gorisht dhe Licensë Marrëveshjes Ballsh;
- (iv) Rrjedhimisht urdhëron MIE dhe AKBN t'i paguajë paditësit shumën prej 12,557,852,1 USD si dëmshpërblim për shkeljen e detyrimeve të tyre sipas nenit 3.1 (c) të Licensë Marrëveshjes Cakran, Licensë Marrëveshjes Gorisht dhe Licensë Marrëveshjes Ballsh;
- (v) Rrëzon pjesën e mbetur të kërkesave të Paditësit për një shpërblim dëmi monetar për shkeljet e ndryshme të të Paditurve të Licensë Marrëveshjes Cakran dhe Licensë Marrëveshjes Gorisht;
- (vi) Rrëzon kërkesën e Paditësit për dëmet monetare sipas Licensë Marrëveshjes së Ballshit në lidhje me pretendimin e dështimit të të Paditurve për të dorëzuar Fushën e Naftës Ballsh;
- (vii) Vendos që paditësi duhet të paguajë 60% të kostove të arbitrazhit dhe që të Paditurit duhet të paguajnë 40% të kostove të tilla, përfshirë shpenzimet e bëra për Seancat Dëgjimore të cilat janë të përbashkëta për





Palët. Rimbursimi i të Paditurve ndaj Paditësit do të ketë interes në normën prej 5 % nga data e këtij Vendimi deri në bërjen e pagesës së plotë;

- (viii) Për pasojë, urdhëron që të Paditurit t'i paguajnë Paditësit shumat prej 292,760, USD dhe 14,451,68, EUR, me interes në normën 5% që nga data e këtij Vendimi deri sa të bëhet pagesa e plotë;
- (ix) Urdhëron që secila palë do të paguajë tarifat e saj ligjore dhe disbursimet;
- (x) Si pasojë, hedh poshtë kërkesën e Paditësit për dëmet monetare për vlerën aktuale të shpenzimeve të G&A të shkaktuara "që nga data e humbjes"


Me qëllim njohjen dhe dhënien fuqi të vendimit të Gjykatës Ndërkombetare të Arbitrazhit, nuk rezulton ndonjë nga pengesat që parashikohen në nenin 394 të Kodit të Procedurës Civile, ashtu sikundër ndonjë prej pengesave të parashikuara në nenin 5 të Konvetes "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit. (Konventa e Neë Yorkut 1958).

#### Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret, kërkesa për njohjen dhe dhënien fuqi ligjore për zbatim në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Arbitrazhit në Gjykatën e Apelit, e paraqitur nga kërkuesi **Shoqëria "GBC Oil Company" LTD Cayman Islands**, përfaqësuar nga dega e shoqërisë së huaj Transatlantic Albania Ltd, ka si bazë ligjore të saj nenin 394 të K.Pr.Civile.

Neni 394 i K.Pr.Civile parashikon: *"Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur:*

- a) *Sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarreveshja nuk mund të jete në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin;*
- b) *Kërkesepadia dhe leterthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'ihënë atij mundësi që të mbrohet;*
- c) *midis po atyre paleve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;*
- ç) *është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prere;*
- d) *i është dhënë forma e prere në kundërshtim me legjislacionin e tij;*
- dh) *nuk pajtohet me parimet baze të legjislacionit shqiptar.*



Referuar legjislacionit ne Republiken e Shqiperise per njohjen e nje vendimi arbitrazhi, se pari për njohjen e një vendimi aplikohen dispozitat dhe kerkesat e Konventes se New Yorkut, ne Nenin 4 te se ciles parashikohen kriteret formale te cilat duhet te permbushen nga pala qe kerkon njohjen dhe ekzekutimin e vendimit.

Kjo palë e duhet te paraqese ne te njejten kohe me kerkesen edhe:

- origjinalin e vendimit, te vertetuar rregullisht ose nje kopje te vertetuar ne menyren e duhur;
- origjinalin e konventes se parashikuar ne nenin 2 ose nje kopje te vertetuar ne menyren e duhur.

Gjithashtu, vendimi duhet te jete i perkthyer ne gjuhen zyrtare te vendit ku jepet vendimi, pra ne gjuhen shqipe.

Referuar aktëve të administruara në gjykim me cilësinë e provës, rezulton e provuar se kriteret e parashikuara ne Nenin 4 te Konventes së New Yorkut permbushen teresisht nga Kerkuesi, pasi prej tij është paraqitur kopja e njehsuar e vendimit që kërkohet të njihet në Republikën e Shqipërisë.

Ne Nenin 5 te Konvetes se New Yorkut parashikohen rastet kur njohja dhe ekzekutimi i vendimit te arbitrazhit mund te refuzohet me kerkesen e pales kunder se ciles drejtohet, vetem ne qofte se ajo pale i paraqet autoritetit kompetent ku kerkohet njohja dhe ekzekutimi, qe:

- palet ne marreveshjen, ne baze te ligjit te zbatueshem per to, ishin te paafta per te vepruar, ose marreveshja ne fjale nuk eshte e vlefshme sipas ligjit, tecilit I jane nenshtruar palet ose mungon ndonje percaktim sipas ligjit te vendit ku eshte dhene vendimi ose
- pales kunder se ciles jepet vendimi nuk i eshte dhene njoftimi i rregullt per caktimin e arbitrit ose te procedures se arbitrazhit, ose, ka qene e paafta per te paraqitur rastin e saj, ose
- vendimi trajton nje mosmarreveshje te paparashikuar ne marreveshjen per arbitrazh ose nuk hyn ne klauzolen mbi arbitrazhin ose permban vendime per ceshtjet qe kalojne fushen, qe i nenshtrohet arbitrazhit;

Megjithate ne qofte se vendimet per ceshtje qe i nenshtrohen arbitrazhit mund te vecohen nga ato qe nuk i jane nenshtruar, ajo pjese e vendimit e cila permban vendime per ceshtje qe i nenshtrohen arbitrazhit, mund te njihet dhe te ekzekutohet; ose

- perberja e autoritetit te arbitrazhit ose e procedures se arbitrazhit nuk ishte ne perputhje me marreveshjen e paleve, ose mungon nje marreveshje e tille, nuk eshte ne perputhje me ligjin e vendit ku eshte zhvilluar; ose



-vendimi nuk ka marre formen perfundimtare per palet, ose eshte anuluar ose pezulluar nga organi kompetent i vendit ne te cilin, ose sipas ligjit te te cilit eshte dhene vendimi.

PO keshtu, pika 2 e Nenit 5 te Konventes se New Yorkut shprehet se njohja dhe ekzekutimi i nje vendimi te arbitrazhit mund te refuzohet gjithashtu ne qofte se autoriteti kompetent i vendit ku kerkohen njohja dhe ekzekutimi konstaton se:  
-objekti i mosmarreveshjes nuk mund te zgjidhet ne rruge arbitrazhi, sipas ligjit te atij vendi, ose  
-njohja ose ekzekutimi i vendimit do te vinte ne kundersiztim me rendin public te ketij vendi.


Ne ceshtjen objekt gjykimi, referuar permbajtjes se vendimit qe kerkohet te njihet gjyqesisht dhe marrveshjeve te lidhura mes palëve në konflikt, nuk ndodhemi ne asnje rast perpara kushteve te sipercituara dhe per rrjedhoje nuk ekziston asnje shkak ligjor per te refuzuar njohjen e vendimit mbi bazen e parashikimeve te mesiperme ligjore.

Lidhur me formen e prere te Vendimit objekt njohje, referuar ligjit te aplikueshem atij Zvicerian, vendimi i Gjykates se Arbitrazhit ka marre forme te prere bazuar ne provat shkresore te cilat jane administruar ne seance.

Ne Nenin 190/1 te Ligjit Zvicerian per te Drejten Nderkombetare Private thuhet: *"Vendimi i arbitrazhit eshte perfundimtar qe prej njoftimit te tij". Gjithashtu, ne Nenin 191 te te njejtit Lig jthuhet: "Ankimi lejohet vetem perpara Gjykates Federale. Procedura rregullohet sipas nenit 77 te ligjit 17 qershor 2005 per Gjykaten Federale".*

Bazuar ne dispoziten e sipercituar, ankimi kunder nje vendimi abitrazhi lejohet vetem prane Gjykates Federale dhe referuar Nenit 100 te Ligjit Zvicerian per Gjykaten Federale, ankimi kunder nje vendimi duhet te depozitohet perpara Gjykates Federale brenda 30 diteve nga njoftimi.

Bashkelidhur kerkeses ne gjykim eshte depozituar ne cilesine e proves edhe nje vertetim leshuar nga Z. Alexander G. Fessas Sekretar i Pergjithshem i Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit te Dhomes Nderkombetare te Tregtise (ICC), nepermjet te cilit konfirmohet se avokatit te pales Paditese si dhe avokatit perfaqesues i te Paditurit Shtetit Shqiptar, jane njoftuar per vendimin e arbitrazhit ne date 26 dhe 28 Korrik 2020 nepermjet postes elektronike zyrtare ne adresat e deklaruar vullnetarisht por edhe nepermjet postes ~~DHE~~ duke u firmosur



konfirmimi per marrjen dijani.

Me date 23 Tetor 2020 ne zbatim te Nenit 35(1) te Rregullores se Gjykates Nderkombetare te Arbitrazhit te Dhomes Nderkombetare te Tregtise (ICC), avokatit te paleve te paditura i është njoftuar shtojca e vendimit perfundimtar e firmosur me date 19 Tetor 2020 dhe rezulton e provuar se asnje nga palet nuk ka ushtruar ankim ne Gjykatën Federale ndaj vendimit te arbitrazhit brenda afatit ligjor 30 ditor. Një fakt i tillë provohet nga vertetimi leshuar nga Gjykata Nderkombetare e Arbitrazhit te Dhomes Nderkombetare te Tregtise (ICC). Per rrjedhoje, vendimi objekt gjykimi ka marre forme te prere dhe nuk paraqet asnje pengese formale per njohje ne Republiken e Shqiperise.

Gjykata e Apelit cmon se sipas vërtetimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nuk rezulton të jetë regjistruar çështje me objekt "Falimenti" në ngarkim të Degës së Shoqërisë së huaj "Transatlantic Albania Ltd-DegaShqipëri", Nipt K72205016P. Njëkohësisht sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërise, mosmarreshja është në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin dhe nga gjykata shqiptare nuk është duke u shqyrtuar ndonjë padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë.

Gjithashtu, vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit është në përputhje me parimet bazë të legjislacionit shqiptar dhe këtij vendimi i është dhënë forma e prerë në përputhje me këtë legjislacion.

Ne keto kushte kur vendimi i arbitrazhit nuk ka asnje pengese ligjore, ai duhet te njihet dhe t'i jepet fuqi zbatimi ne Republiken e Shqiperise.

Për sa më sipër, nga Gjykata e Apelit çmohet se kërkesa e kerkuesit **Shoqeria "GBC Oil Company" LTD Cayman Islands**, përfaqësuar nga dega e shoqërisë së huaj **Transatlantic Albania Ltd** duhet të pranohet, pasi vendimi i Gjykates Ndërkombetare të Arbitrazhit Zyrih, Zvicër, nuk është në kundërshtim me legjislacionin shqiptar.

### PER KETO ARSYE

Gjykata e Apelit Tirane, bazuar në nenet 395, 396 dhe 397 të Kodit të Procedurës Civile,




**VENDOSI**

-Njohjen dhe dhënie fuqi ligjore për zbatim në Republikën e Shqipërisë të vendimit Nr.22676/GR të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Zyrih, Zvicër, date 06.07.2020, në çështjen e arbitrazhit midis GBC OIL COMPANY LTD (Ishujt Kajman) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKBN dhe AlbPetrol sh.a. Republika e Shqipërisë.

**Tiranë, sot më date 04.05.2021.**


**ANËTARE**

**Elona TORO**




**ANËTARE**

**Zegjine SOLLAKU**



**KRYESUESE**

**Elbana LLURI**



**Vërtetohet që ky vendim ka marrë formë të prerë**

**Kryesekretare  
Rudina BUBJAKU**

PULLE TARRË



R.SHQIPERISE

